



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KËSHILLI PROKURORIAL KOSOVA - TUZILACKI SAVET KOSOVA SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT ARKIVA - ARHIVA		
Pranuar	22 -04- 2022	Primitjeno
Numri rendor Redni broj	Ora e pranimit Ças prijema	Nenshkrimi i prantuesit Potpis primaoca
674		

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.5/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Beshir Islami dhe Nebojša Boričić, anëtarë, në çështjen juridike disiplinore ndaj Valdet Avdiu, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tej KPK), për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur sipas ankesës së prokurorit Valdet Avdiu, paraqitur kundër Vendimit KPK/Nr.413/2022, datë 22 mars 2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 19.4.2022 merr këtë:


AKT GJYKIM

I. Pranohet pjesërisht si themeltë ankesa e Valdet Avdiu, prokurorinë Prokurorinë Themelore në Ferizaj, Ndryshohet vendimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK.nr.413/2022, datë 22 mars 2022 dhe atë nën pikën III të dispozitivit të vendimit sa i përket sanksionit disiplinor, ashtu që këtij prokurori i shqiptohet masa disiplinore, “zvogëlimi i përkohshëm i pagës prej 50% për një periudhë kohore prej 6 (gjashtë) muajve”.

II. Në pjesën tjetër ankesa e Prokurorit Valdet Avdiu, paraqitur kundër vendimit të sipërpërmendur, refuzohet si e papabuar.

A r s y e t i m

Me vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK/Nr.413/2022, datë 22 mars 2022, në pikën I, të dispozitivit, aprovohet si i bazuar Raporti i Panelit hetimor, AD nr.09/2021 i datës 30 dhjetor 2021, në rastin disiplinor kundër prokurorit Valdet Avdiu, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj. Në pikën II, dispozitivit të vendimit vërtetohet se, prokurori është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara me nenin 6, paragrafi 2.1 nën paragrafin 2.10



të Ligjit Nr. 06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Në pikën III të dispozitivit, prokurorit Valdet Avdiu, i shqiptohet masa disiplinore transferim i përhershëm në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, në Departamentin e përgjithshëm, sipas nenit 7, paragrafi 1, pika 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Kundër këtij Vendimi, prokurori Valdet Avdiu, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të aplikimit të gabuar të drejtës materiale, shkeljeve procedurale të përcaktuara me ligj dhe gabimeve faktike që kanë ndikuar në procedurë dhe vendimmarrje lidhur me masën disiplinore, me propozim që Gjykata Supreme ta aprovoi ankesën dhe të ndryshoj vendimi e goditur duke e liruar nga përgjegjësia disiplinore ose të ndryshoj masën disiplinore të shqiptuar, me donjë masë ma të butë, në pajtim me shkeljen e gjetur.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në përgjigje ndaj ankesës së prokurorit pretendon se, ankesa është e pa bazuar dhe se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë edhe për faktin se në veprimet e prokurorit Valdet Avdiu ka elemente të veprës disiplinore nga neni 6, paragrafi 2 nën paragrafi 2.10 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor theksojnë se sanksioni disiplinor ndaj prokurorit është adekuat, në përputhje me të gjeturat e panelit hetimor dhe do të ketë efekt pozitiv në punën e prokurorit në të ardhmen.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të vendimit të atakuar në kuptim të nenit 15 të Ligjit për përgjegjësin disiplinore të gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji numër 06/L-057) ka gjetur se:

Ankesa pjesërisht është e bazuar.

Në shkresat e lëndës del se më datën 28 tetor 2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka pranuar nga Autoritetit Kompetent propozimin për fillimin e procedurës hetimore ndaj Valdet Avdiu, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, me propozim që të njëjtit t'i shqiptohet masa disiplinore zvogëlimi i përkohshëm i pagës deri në 50% për një periudhë deri 1 (një) vit. Me 2 nëntor 2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës, ka themeluar Panelin Hetimor për hetimin e rastit disiplinor, ndaj prokurorit Valdet Avdiu, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj.

Më 30 dhjetor 2021, Paneli Hetimor i ka dorëzuar raportin Këshillit Prokurorial të Kosovës me përfundim se Prokurori Valdet Avdiu, ka vepruar në shkelje të nenit 6 paragrafi 2.1 pika


2.10. Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe dispozitat e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror sepse në rastin e parë, AD.nr. 09/2021, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi ashtu që në lëndën penale, [REDACTED] që ka të bëjë me ndodhjen e aksidentit të komunikacionit mes dy automjeteve të përfshira ku si pasojë pesë persona kanë gjetur vdekjen në mesin e tyre një i mitur, ndërsa prokurori Valdet Avdiu e zëvendëson masën e paraburgimit në arrest shtëpiak dhe ka ngritur aktakuzë pa kryer hetimet.

Në kësi rrethanash KPK-ja pasi shqyrtoi provat dhe dëgjoji palët, në seancën e datës 12 janar 2022 vendosi si në dispozitivin e vendimit të atakuar.

Duke u nisur nga kjo gjendje çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, i pranon si të themelta konstatimet faktike dhe qëndrimin juridike të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe vlerëson të ligjshëm vendimin e KPK, lidhur shkeljen dhe përgjegjësinë disiplinore të prokurorit, prandaj edhe pretendimet ankimore në këtë drejtim janë të pabazuara. Në veprimet e prokurorit Valdet Avdiu ekzistojnë të gjitha elementet e veprës disiplinore nga neni 6 paragrafi 2 nën 2.10 të Ligjit për përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Prokurorëve sepse i njëjti me paraqitjen e kërkesës për zëvendësimin e masës së paraburgimit në arrest shtëpiak, akoma pa i siguruar të gjitha provat materiale, ka dëmtuar besimin e publikut në paanshmëri ose besueshmërinë e prokurorit të shteti. Në bazë të nenit neni 6 paragrafi 2.1 nën paragrafi 2.10 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e cila përfshin veprimet e prokurorit *“ përfshihet në sjellje, qoftë kur është në detyrë ose privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e prokurorit të shtetit ose që mund të dëmtojnë reputacionin e prokurorit të shtetit ose mund të dëmtoj besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e prokurorit të shtetit ”*

Me provat e administruara gjatë zhvillimit të procedurës hetimore, është vërtetuar se paraqitësi i ankesës ka kryer veprime disiplinore për të cilat është ngarkuar dhe se pakujdesia nuk e liron nga përgjegjësia disiplinore nga fakti se prokurori në ushtrimin e funksionit të tij duhet ta njeh dhe ta zbatoj ligjin dhe aktet tjera juridike.

Pretendimet e parashtruesit të ankesës se sanksioni disiplinor i shqiptuar, është në s'përputhje me parimin e proporcionalitetit nga neni 7.2 të Ligjit në fjalë, është i bazuar nga fakti se parashtruesi i ankesës ka qenë në nivelin e bashkëpunimit gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore, është përgjigjur ftesave në procedurë disiplinore. Vendimi e KPK sa i përket lartësisë (vëllimit) të sanksionit të shqiptuar disiplinor ndaj prokurorit Valdet Avdiu, për



shkeljen disiplinore të sipër cekur , nga ana e KPK , në këtë pjesë vendimi nuk është në harmoni të plotë me parimin e proporcional, si dhe duke marrë parasysh seriozitetin e shkeljes disiplinore , rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore , sjelljen e përgjithshme si dhe të mëparshme të prokurorit (par.2 neni 7 i LPDGJP-së), ndaj, nga këtu, u dashtë që në këtë pjesë, vetëm përkitazi me lartësinë(vëllimin) e sanksionit të shqiptuar disiplinor, të ndryshohet vendimi i KPK-së, si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, si një masë proporcionale dhe adekuate në raport me shkeljen e kryer disiplinore dhe se e njëjta do të shërbejë si masë për preventimin e shkeljeve, përkatësisht, disiplinimin jo vetëm të ankuesit, por, edhe për të tjerët.

Me këtë rast, kjo Gjykatë, përveç kritereve të mësipërme, mori parasysh edhe praktikën e deritanishme të vendosjes së organeve kompetente ligjore përkitazi me shkeljet e njëjta disiplinore dhe respektimit të barazisë së plotë dhe unike në trajtimin e çështjeve përkatëse disiplinore .

Prandaj, me shqiptimin e sanksionit disiplinor, zvogëlimin e pagesë prej 50% për 6 muaj, mund të arrihet qëllimi i shqiptimit të sanksionit disiplinor. Prandaj, në këtë pjesë gjykata e aprovoi ankesën e prokurorit Valdet Avdiu duke ia shqiptuar masën disiplinore në fjalë.

Për arsyet e paraqitura më lartë dhe në bazë të dispozitës së nenit 15.6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË
A.A.nr.5/2022 datë 19 prill 2022

Kryetar i kolegjit
Erdogan Haxhibeqiri





GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës AA 5/202
 Oznaka spisa: 21-04-202

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE
 KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashur të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fqit, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokusajo dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u odredjeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domacin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtarit i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno clan njenog domacinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribijeno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
 dana _____ u _____ čas.
 Shkaku i refuzimit të marrjes _____
 Razlog odbijanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljava

Emri i shkresës që dorëzohet:
 Naslov pisma koja se dostavlja:

1 - Allegorija, 10/1
 19.04.2022

Numri i shtojcave: - 2 kopje -
 broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartëpërmendur
 më (me fjalë)
 Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
 (i slovima)

22.04.2022 [Signature]
 (Nënshkrimi i marrësit ose i tij që
 e ka marrë aktin në vend të tij
 Potpis primaoca ili lica koje je
 pismeno primilo u zamenu)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljava

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaku për marrësin nuk e ka vendë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač, napomenom zašto primilac nije stavio svoj potpis.

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrtafi)